

ANEKSI Nr. 1**KUSHTET E VEÇANTA TË SHËRBIMEVE DHE TARIFAVE**

Në këtë Aneks, pasqyrohen shërbimet bazë dhe shtesë të ofruara nga ONE ALBANIA SHA. dhe të zgjedhura nga Pajtimtari, kushtet e veçanta, tarifat përkatëse të shërbimeve si dhe mënyra e tarifimit.

- Plani ONE START me Kontrate

| Programi | ONE Start |
|--|--|
| Pajtimi Mujor | 700 |
| Minuta Kombëtare ¹ | 1,000 |
| Minuta Ndërkombëtare | |
| SMS Kombëtare/Nderkombëtare* ¹ | 150 |
| Internet | 1GB |
| Internet Bonus | 1GB |
| Internet me shpejtesi te reduktuar | Pa limit |
| Tarifat/Minutë (pas konsumimit të njësive falas) | |
| Minuta drejt të gjitha destinacioneve Kombëtare | 9.0000 |
| Tarifat/Sekondë (pas konsumimit të njësive falas) | |
| Kombëtare | 0.1500 |
| Shërbime të tjera | |
| SMS Kombëtare | 4.0000 |
| SMS Ndërkombëtare | 9.0000 |
| Tarifat ndërkombëtare/minutë (pas konsumimit të njësive falas) | |
| Zona 1 | 59.9900 |
| Zona 2 | 110.9900 |
| Zona 3 | 125.9900 |
| Zona 4 | 227.9900 |
| Zona 5 | 359.9900 |
| Tarifat ndërkombëtare/sekondë | |
| Zona 1 | 0.9998 |
| Zona 2 | 1.8498 |
| Zona 3 | 2.0998 |
| Zona 4 | 3.7998 |
| Zona 5 | 5.9998 |
| Internet ONE + | 5GB – 500 Lekë |
| Paketat e Internetit Roaming | |
| Paketa Ditore Internet, 150 MB = 250 lekë | Paketat janë te vlefshme në të gjithë operatorët e Zonës 1 |
| Paketa Javore Internet, 700 MB = 800 lekë | |
| Paketa 2-javore, 8 GB, 100 minuta drejt ONE, 10 minuta drejt të gjithëve, 50 minuta hyrëse, 100 SMS = 2,000 lekë | |

1. SMS-të e përfshira në paketë janë të vlefshme drejt të gjitha destinacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Minutat dhe SMS kombetare jane te vlefshme edhe ne Roaming ne Ballkanin Perendimor.
3. Maksimumi i vëllimit te Internetit i cili eshte i vlefshem edhe ne Roaming ne Ballkanin Perendimor: 2 GB

Tarifat Standarde të Shërbimit Roaming:**1- Tarifat Standarde të Shërbimit Roaming per Ballkanin Perendimor:**

| Telefonata Dalese ne Roaming | KOMBETARE | | DESTINACIONE TE TJERA | |
|------------------------------|-------------------------|--------------|---------------------------|--------------|
| | leke/minute | leke/sekonde | leke/minute | leke/sekonde |
| | 9 | 0.15 | 120 | 2 |
| Telefonata Hyrese ne Roaming | NGA SHTETET BP/Shqiperi | | NGA DESTINACIONE TE TJERA | |
| | FALAS | | 100 | 1.667 |
| SMS Dalese ne Roaming | KOMBETARE | | DESTINACIONE TE TJERA | |
| | Leke/SMS | | Leke/SMS | |
| | 4 | | 15 | |
| SMS Hyrese ne Roaming | FALAS | | | |
| Internet ne Roaming | leke/MB | | leke/10KB | |
| | 1.14 | | 0.0111 | |

2- Tarifat Standarde të Shërbimit Roaming:

| TELEFONATA NË ROAMING | TELEFONATA DALËSE NË ROAMING | | TELEFONATA HYRËSE NË ROAMING | |
|-----------------------|------------------------------|--------------|------------------------------|--------------|
| | lekë/ minutë | lekë/sekondë | lekë/ minutë | lekë/sekondë |
| Zona 1 | 120 | 2.0000 | 100 | 1.6667 |
| Zona 2 | 520 | 8.6667 | 100 | 1.6667 |
| Zona 3 | 780 | 13.0000 | 100 | 1.6667 |
| SMS në Roaming | SMS Dalëse lekë/SMS | | SMS Hyrëse lekë/SMS | |
| Zona 1 | 15 | | FALAS | |
| Zona 2 | 15 | | | |
| Zona 3 | 15 | | | |
| Internet në Roaming | lekë/MB | | lekë / 10 KB | |
| Zona 1 | 50 | | 0.4880 | |
| Zona 2 | 180 | | 1.7580 | |
| Zona 3 | 1,600 | | 15.6250 | |

SHËNIME TË PËRGJITHSHME

- 1) Të gjitha tarifat e përcaktuara më sipër përfshijnë TVSH-në.
- 2) Benefitet e përfshira në program janë të vlefshme për një periudhë 1 mujore dhe nuk janë të transferueshme në muajt në vijim.
- 3) Pajtimi mujor dhe njësitë të përfshira në paketë (minuta, SMS, MB) janë proporcionale në varësi të datës së aktivizimit. Ky kusht aplikohet për të gjitha mënyrat e abonimit: aktivizim i ri, transferim, tjetërsim.

- 4) Koha fillestare e tarifimit është 60 sekonda, më pas do të aplikohet tarifimi për sekondë
- 5) Përlllogaritja e konsumimit të internetit do të bëhet për çdo 10 KB.
- 6) Interneti pas përfundimit të njesive do të jete me shpejtesi të reduktuar 128 Kbps. Pajtimtari mund të rikthejë shpejtësinë 4G të internetit brenda muajit duke blerë një paketë ekstra me GB sipas ofertave.
- 7) Pajtimtari që ka zgjedhur një prej planeve të tarifimit të mësipërme në fillim të çdo muaji do të përfitojë automatikisht Internet me shpejtësi 4G.
- 8) Pajtimtari mund të ndryshojë në çdo kohë planin e tij tarifor, në një plan tjetër tarifor me pajtim mujor më të lartë.
- 9) Kohëzgjatja fillestare, minimale e kontratës është 12 muaj. Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës prej Pajtimtarit brenda afatit fillestar 12 mujor apo 24 mujor, Pajtimtari ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerën e tarifës mujore fikse për të gjithë muajt e mbetur deri në përfundimin e afatit të kontratës 12 mujore ose 24 mujore.
- 10) Në rastet kur Pajtimtari ka përfituar një zbritje në çmimin e aparatit të marrë si ofertë specifike, dhe kërkon zgjidhje të parakohshme të kontratës, përveç penalitetit të shënuar me sipër dhe vlerës së plotë korresponduese të ofertës specifike, duhet të paguajë gjithashtu dhe vlerën korresponduese të zbritjes së përfituar në çmimin e aparatit.
- 11) Në rastet kur pajtimtari ka përfituar nga ndonjë oferte promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promovionale, dhe vendos të kryejë zgjidhje të parakohshme të kontratës, së bashku me detyrimet e sipërpërmenduar duhet të paguajë edhe përfitimet nga oferta promovionale. (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
- 12) Në rast se Pajtimtari do të ndryshojë planin, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerën e diferencës së pagesës fikse mujore për të gjithë muajt e mbetur.
- 13) Në rastet kur Pajtimtari ka përfituar një zbritje në çmimin e aparatit të marrë si ofertë specifike, dhe kërkon të beje ndryshim e planit, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, ka detyrim të paguajë si penalitet, përveç penalitetit të shënuar me sipër duhet të paguajë gjithashtu dhe vlerën korresponduese të zbritjes së përfituar në çmimin e aparatit.
- 14) Në rastet kur pajtimtari ka përfituar nga ndonjë oferte promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promovionale, dhe vendos do të ndryshojë planin, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, së bashku me detyrimet e sipërpërmenduar duhet të paguajë edhe përfitimet nga oferta promovionale. (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
- 15) Kufiri maksimal i kreditimit i shprehur në lekë, për përdorimin e shërbimeve prej Pajtimtarit sipas programit të zgjedhur, përcaktohet në formularin e pajtimit bashkëlidhur, pjesë e pandashme e kontratës së pajtimit. Shuma e përcaktuar si limit krediti do të aplikohet në përputhje me planin tarifor të zgjedhur prej pajtimtarit. Ky kredit limit do të përdoret për shërbime të cilat nuk janë të përfshira në programin tarifor të zgjedhur, duke i ofruar Pajtimtarit fleksibilitet në përdorim dhe njëkohësisht edhe mundësi për të kontrolluar shpejzimet. Pajtimtari mund të përditësojë në çdo moment limitin e kreditit. Ky përditësim mund të bëhet në çdo dyqan One.
- 16) Në fakturën e pare do të pasqyrohen detyrimi i muajit paraardhës (proporcional) dhe pagesa fikse mujore e muajit aktual. Pagesat fikse mujore në vijim do të aplikohen çdo ditë 1 të muajit kalendarik. Në fakturën mujore të lëshuar, do të shfaqet vetëm vlera e pagesës mujore fikse e muajit aktual, sipas planit tarifor të zgjedhur.
- 17) Për të mesuar me shumë mbi shtetet dhe zonat ndërkombetare klikoni: <https://www.one.al/>
- 18) Për të mesuar me shumë mbi zonat, shtetet, operatorët, paketat dhe tarifat për njësi për shërbimin Roaming klikoni: <http://smartroam.one.al/>

SHËNIME PËR SHËRBIMIN ROAMING

- 19) Paketat, ofertat dhe koha e bisedës falas që pajtimtari ka përfituar duke aktivizuar ndonjë nga paketat bazë apo ato opsionale, nuk janë të vlefshme dhe nuk mund të konsumohen ndërkohë që klienti përdor shërbimin Roaming, përveç shteteve të Ballkanit Perëndimor.. Gjatë përdorimit të shërbimit Roaming, do të aplikohen tarifat e përcaktuara dhe të sipërpërmendura në tabelën 'Tarifat standarde të shërbimit Roaming'.
- 20) Interneti në roaming do të tarifohet për çdo 10 KB. Pas përfundimit të MB të përfshira në paketë, do të aplikohen tarifat standarde të vlefshme në Roaming.
- 21) Koha fillestare e bisedës për telefonatat hyrëse dhe dalëse në Roaming është 60 sekonda. Pas përfundimit të kohës fillestare gjatë këtij shërbimi do të aplikohet tarifimi për sekondë.
- 22) Në mënyrë që të aktivizohet paketat internet të vlefshme për në roaming (Paketa Ditore, Javore dhe 2-Javore) pajtimtari duhet të sigurohet të aktivizojë shërbimin standard Roaming duke kontaktuar ONE nëpërmjet njëres prej pikave të shitjes.
- 23) Në përputhje me dokumentin referencë ndërkombetar të përhershëm të GSMA, datë 16.12.2014, Versioni 24.6, "Afatet për transferimin e të dhënave data" për marrëveshjet e Roaming ku shoqëria ONE ALBANIA SHA është palë, në raste të vecanta, mund të krijohen vonesa të shkëmbimit të të dhënave roaming deri në 30 ditë midis operatorëve në marrëdhënie roaming me

njëri-tjetrin. Për këtë arsye, në keto raste detyrimi për pajtimtarin për shërbimet roaming të konsumuara në muajin paraardhës mund të pasqyrohen në faturën në vijim në muajin pasardhës

SHËNIME TË TJERA PËR ZONËN BALLKANI PERENDIMOR:

- 24) Të gjithë Klientët që i përkasin programeve me kontratë ONE Simple, ONE Start, ONE More, ONE Advance, ONE Pro dhe ONE Elite, të rinj dhe ekzistues të cilët do të vizitojnë Shtetet e Ballkanit Perendimor do të mund të përdorin njesite e përfshira në programin e tyre (minuta kombetare, SMS kombetare, Internet) FALAS sikur të ishin në territorin Shqiptar, duke i zbritur ato nga programi perkates me konceptin Roam Like at Home (RLAH).
 - i. ONE ka të drejte të aplikojë Politiken e Përdorimit të Drejte të Shërbimit të Dhenave në Roaming sipas Rregullores së AKEP, specifikuar me siper.
 - ii. Pas konsumit të njesive data internet të lejuara në programin perkates, ONE do të aplikojë një tarifë shtesë prej 1.14 leke/MB.
- 25) Telefonata dhe SMS Dalese Kombetare quhen të gjitha thirrjet e gjeneruara nga shtetet e Ballkanit Perendimor dhe të terminuara në operatorët celularë të shteteve të Ballkanit Perendimor dhe të Shqipërisë. “Destinacionet e tjera” janë operatorët fiks në Shqipëri & Ballkanin Perendimor si dhe shtetet e tjera nderkombetare dhe do të tarifohen sipas tabelës me siper.
- 26) Thirrjet hyrese prej operatorëve celularë të Ballkanit Perendimor dhe Shqipërisë janë FALAS. Të gjitha thirrjet e tjera të terminuara nga shtetet e tjera (operatorët fiks Shqipëri/ Ballkani Perendimor dhe shtetet e tjera nderkombetare) do të tarifohen sipas tabelës me siper.
- 27) Të gjitha SMS hyrese janë FALAS.
- 28) Tarifimi i minutave dalese do të kryhet fillimisht për 60 sekondat e para dhe më pas do të vazhdojë për çdo sekondë.
- 29) Tarifimi i minutave hyrese do të kryhet fillimisht për 30 sekondat e para dhe më pas do të vazhdojë për çdo sekondë.
- 30) Interneti do të tarifohet për çdo 10 KB.
- 31) Shteti i Kosovës, Bosnie Hercegovines, Mali i zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia do të vazhdojë të jetë të përfshirë tek paketat aktuale të vlefshme në Roaming dhe do të vazhdojnë të ofrohen në treg si një alternativë shumë e mirë për klientët me kontratë. (të gjitha rrjetet janë të përfshira në këto paketa). Në keto raste, njesite të përfshira në program me konceptin RLAH do të kenë prioritet mbi paketat Roaming.

Pajtimtari deklaron se ka lexuar dhe është plotësisht në dijeni të Kushteve të Përgjithshme të dhënies së shërbimeve të telefonisë publike të lëvizshme për Pajtimtarin, të cilat janë pasqyruar dhe mund të aksesohen në link-un e mëposhtëm:

<https://www.one.al/kushtet-e-pergjithshme>

Pajtimtari deklaron se i ka pranuar pa rezerva dhe nën vullnetin e tij të lirë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtimtarit.

Këto Kushte të Përgjithshme së bashku me Kushtet e Veçanta të Shërbimeve dhe Tarifave në fuqi, përbëjnë tërësinë e marrëveshjes ndërmjet palëve për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacioneve prej ONE dhe faturimin përkatës të Pajtimtarit.